



ANALIZË: REFLEKTIMI I OBJEKTIVAVE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM NË PROGRAMIN E QEVERISË

2020 – 2023

Prishtinë // 2020



The views expressed in this publication are not necessarily those of the Friedrich Ebert Foundation or of the organizations for which the authors work.

The publication is available online at www.fes-prishtina.org



**ANALIZË:
REFLEKTIMI I OBJEKTIVAVE
PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM
NË PROGRAMIN E QEVERISË
2020 – 2023**

Përmbajtje

| | |
|---|----|
| 1. Hyrje: Agjenda 2030 në Kosovë | 5 |
| 2. Metodologjia | 6 |
| 3. Niveli i reflektimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Programin e Qeverisë 2020 – 2023 | 7 |
| 3.1. Programi i Qeverisë 2020 – 2023 | 7 |
| 3.2. Niveli i reflektimit të qëllimeve të OZhQ-ve në Programin e Qeverisë | 8 |
| 4. Përfundime dhe Rekomandime | 12 |

I. Hyrje: Agjenda 2030 në Kosovë

Në Shtator të vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën "Transformimi i botës: Agjenda e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm". Kjo agjendë është një plan që ka për qëllim të adresoj sfidat që kanë të bëjnë me njerëzit, planetin, prosperitetin, paqen dhe partneritetin (5Ps). Kjo agjendë e vitit 2030 ka 17 objektiva, 169 qëllime (targets) dhe 232 tregues unik. Në mënyrë që të arrihet një zbatim sa më i lartë dhe që askush të mos të lihet prapa, është e rëndësishme që të gjitha palët të jenë të përfshira në këtë proces si Kuvendi, Qeveria, sektori privat dhe shoqëria civile.

Për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ), vendet pritet të marrin pronësinë dhe të krijojnë një kornizë kombëtare dhe të integrojnë ato në programe dhe strategji kombëtare dhe sektoriale. Qeveria ende nuk ka përgatitur një kornizë kombëtare për zbatimin e OZhQ-ve apo ndonjë raport monitorimi. Por Qeveria ka një program i cili përcakton nivelin më të lartë të angazhimit dhe udhëheqjes politike për zhvillimin e vendit, gjithashtu ky program shërben si kornizë për të gjitha përpjekjet e nevojshme në të gjithë sektorët dhe të gjitha nivelet.

Përfshirja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në programet politike dhe platformat qeverisëse të tilla si Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është shumë i rëndësishëm për të mveshur këto objektiva me mbështetjen politike të domosdoshme për realizimin e tyre. Kësisoj, bëhet e rëndësishme të hartojmë një analizë për të parë nivelin e integritit të këtyre objektivave në Programin Qeverisëse. Sa më i madh niveli i përfshirjes së tyre në programin qeverisëse, aq më i madh shpresohet të jetë progresi në zbatimin e tyre dhe në implementimin e kornizës së plotë 2030 të Kombeve të Bashkuara.

Vlen të theksohet se integrimi dhe zbatimi i OZhQ-ve ka edhe ndikime financiare, prandaj sigurimi i burimeve financiare përbën një shtyllë mjaft të rëndësishme. Përfshirja dhe zbatimi i OZhQ-ve ndikon se si donatorët do të i orientojnë fondet e tyre për zhvillim, dhe si Qeveria do të programojë shpenzimet e buxhetit.

Ky punim analizon nivelin e reflektimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZhQ) në Programin e Qeverisë 2020 – 2023. Kjo analizë përfshinë vlerësimin e gatishmërisë së Programit të Qeverisë për reflektimin e OZhQ-ve dhe ndërlidhjet midis tyre në nivel vendi. Vlen të theksohet se kjo analizë bëhet për herë të parë në këtë format. Kjo analizë mund të përdoret si hap i parë në përcaktimin e integritit dhe zbatimit të OZhQ-ve. Pjesa kryesore paraqet analizën për nivelin e reflektimit të OZhQ-ve dhe se cilat objektiva të Programit të Qeverisë kontribuojnë drejt arritjes së 17 objektivave dhe 169 qëllimeve (targets) relevante për Kosovën.

II. Metodologjia

Kjo analizë vlerëson nivelin e reflektimit të OZhQ-ve në Programin e Qeverisë 2020- 2023. Objektivat e programit analizohen veç e veç duke krahasuar ato me të gjitha qëllimet relevante të OZhQ-ve. Analiza përfshin edhe reflektimin e qëllimeve sipas pesë tematikave (5Ps). Për të pasuruar këtë analizë është përdorur mjete i Vlerësimit për Integrim të Shpejt (RIA)¹. Ky mjet synon të mbështesë vendet që të identifikojnë dhe përfshijnë OZhQ-të në planifikimin kombëtar.

Për të vlerësuar se sa reflektohen qëllimet e OZhQ-ve në Programin e Qeverisë janë marrë parasysh katër kategori si më poshtë:

- ◆ Nuk është relevante: kur një qëllim nuk është i rëndësishëm për zhvillimin e politikave të Kosovës, ose ka të bëjë me çështjet e qeverisjes që do të zgjidhen në nivelin rajonal ose global.
- ◆ Tërësisht në përputhje (T): kur qëllimi i OZhQ-ve ekziston në Programin e Qeverisë, jo vetëm në tekst, por edhe në përmbajtje.

¹ Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), 2017. Vlerësimi për Integrim të Shpejt. E qasshme në: <https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/sustainable-development-goals/rapid-integrated-assessment---mainstreaming-sdgs-into-national-a.html>

- ◆ Pjesërisht në përputhje (P): kur qëllimi i OZhQ-ve ekziston në Programin e Qeverisë, por jo plotësisht i njëjtë në përmbajtje, ose nuk ka tregues për të matur përparimin e tyre.
- ◆ Nuk është në përputhje: kur qëllimi i OZhQ-ve nuk ekziston në Programin e Qeverisë.

Për të bërë dallimin rreth qëllimeve tërësisht në përputhje nga ato pjesërisht në përputhje, janë marrë parasysh kriteret si:

- ◆ Qëllimi i OZhQ-ve duhet të jetë në një ose më shumë objektiva të Programit të Qeverisë; Qëllimi i OZhQ-ve dhe objektivat e Programit të Qeverisë duhet të kenë një rezultat të njëjtë final dhe
- ◆ Disagregimi i objektivave të Programit të Qeverisë duhet të jenë sipas gjinisë, moshës, vendbanimit, etj. ashtu siç kërkohen nga qëllimet e OZhQ-ve.

Nëse plotësohen të tre kriteret atëherë kjo nënkupton tërësisht në përputhje ndërsa nëse plotësohen vetëm kriteret 1 dhe 2 ose 1 dhe 3, atëherë kjo nënkupton pjesërisht në përputhje. Gjetjet kryesore dhe rekomandimet për nivelin e përfshirjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Programin e Qeverisë 2020 – 2023 janë në vijim të analizës. Gjetjet dhe rekomandimet janë mjaft të rëndësishme në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë në përfshirjen e OZhQ-ve në Program dhe fushat të cilat Qeveria duhet të fokusohet.

III. Niveli i reflektimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Programin e Qeverisë 2020 – 2023

3.1. Programi i Qeverisë 2020 – 2023

Në programin qeverisës 2020-2023², Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet se do të mbrojë dhe zbatojë të gjitha parimet dhe normat që burojnë nga Kushtetuta e Kosovës. Ky program parasheh objektiva dhe prioritete që duhen ndërmarrë brenda katër viteve për të zbatuar politika që e rrisin cilësinë e jetës, që respektojnë të drejtat e secilit dhe ofrojnë mundësi të barabarta në arsim, shëndetësi, në jetën sociale dhe në shërbimet publike në përgjithësi. Programi mbështetet në 14 objektiva dhe prioritete siç janë: 1) Menaxhimi i pandemisë nga COVID-19; 2) Rimëkëmbja Ekonomike pas pandemisë; 3) Qeverisja, Reforma Institucionale dhe Kohezioni Shoqëror; 4) Zhvillimi Ekonomik gjithëpërfshirës dhe i Qëndrueshëm; 5) Drejtësi e pavarur dhe efikase; 6) Politika e jashtme, integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë; 7) Arsimi dhe Shkenca; 8) Shëndetësia; 9) Bujqësia dhe Zhvillimi Rural; 10) Infrastruktura, Energjia, Minierat, Ujërat dhe Ambienti; 11) Mbrojtja dhe Siguria Publike; 12) Mbrojtja Sociale dhe integrimi në Punësim; 13) Kultura, Rinia dhe Sporti dhe 14) Diaspora.

Programi ofron një narrativ ambicioz për zbatimin e çdo prioriteti. Megjithatë, programi mbetet i kufizuar në matjen e objektivave dhe prioriteteve të saj në kontekstin se në çfarë niveli është Kosova tani dhe cakun që duhet të arrijë. Të gjitha objektivat e programit trajtohen në mënyrë të pavarur, mirëpo askund në program nuk shpjegohen tiparet e përbashkëta apo ndërlidhja me objektivat e OZhQ-ve. Në kapitullin vijues diskutohet gjerësisht analiza për reflektimin e OZhQ-ve.

² Zyra e Kryeministrit, 2020. Programi i Qeverisë 2020 – 2023.

E qasshme në: <https://kryeministri-ks.net/ep-content/uploads/2020/06/Programi-Qeverises-2020-2023-final-05062020.pdf>

3.2. Niveli i reflektimit të qëllimeve të OZhQ-ve në Programin e Qeverisë


Për të kuptuar nivelin e integritit të OZhQ-ve në Kosovë është e rëndësishme të kuptojmë nivelin në të cilin Programi i Qeverisë i integron objektivat e OZhQ-ve. Pra programi është shumë thelbësor në këtë drejtim pasi që të gjitha veprimet dhe politikat Qeveritare bazohen në këtë program duke përcaktuar kështu shpërndarjen e burimeve për zbatimin e aktiviteteve relevante brenda periudhës sa është duke u zbatuar ky program.

Duke u bazuar në **rezultatet e analizës**, vlerësimi gjen një nivel të ulët të reflektimit të qëllimeve të OZhQ-ve në Programin e Qeverisë: vetëm 35 nga 100 qëllime të OZhQ-ve që konsiderohen të rëndësishme për Kosovën gjejnë një referencë të plotë në programin e Qeverisë të është përfshirë në analizë³. Ndërsa 36 nga 100 qëllime të OZhQ-ve që konsiderohen të rëndësishme për Kosovën gjetën referencë të pjesshme në programin e Qeverisë.

Boshllëqet më të theksuara janë në OZhQ-2 për eliminimin e urisë, OZhQ-3 për shëndet të mirë dhe mirëqenie, OZhQ-7 që ka të bëjë me energji të përbalueshme dhe të pastër, OZhQ-8 për punë dinjitoze dhe rritje ekonomike të qëndrueshme, OZhQ-9 për ndërtimin dhe promovimin e industrializimit, inovacionit dhe infrastrukturës, OZhQ-10 që ka të bëjë me uljen e pabarazive, OZhQ-12 për konsum dhe prodhim të përgjegjshëm, OZhQ-13 që ka të bëjë me ndërmarrjen e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimin dhe efektet klimatike, dhe OZhQ-15 për jetën në tokë që ka të bëjë me mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshmërisë të ekosistemeve tokësore, pyjeve, luftimi i shkretëtimit si dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit. Figura 1 më poshtë shfaq një pasqyrim vizual të mbulimit të qëllimeve të OZhQ-ve në Kosovë.

³ Analiza nuk ka përfshirë qëllimet që lidhen me mjetet e zbatimit dhe partneritetet (këto janë 43 qëllime nën OZhQ të ndryshme), dhe nuk janë përfshirë të gjitha 26 qëllimet nën OZhQ-14 dhe OZhQ-17 (pra nuk janë përfshirë gjithsej 69 qëllime të OZhQ-ve).

Figura 1: Reflektimi i OZhQ-ve në Programin e Qeverisë 2020 – 2023



Siç paraqitet në rezolutën e miratuar në Shtator të vitit 2015 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara⁴ miratoi rezolutën "Transformimi i botës: Agjenda e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm", OZhQ-të janë grupuar në pesë fusha ose tema koherente (5Ps): Njerëzit, Planeti, Prosperiteti, Paqja dhe Partneritetet. Një përmbledhje e përfshirjes së OZhQ-ve në Programin e Qeverisë sipas temave është paraqitura në tabelën 1 më poshtë.

⁴ Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 2015. Transformimi i botës: Agjenda e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm. E qasshme në: https://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E

Tabela 1: Reflektimi i OZhQ-ve në Programin e Qeverisë sipas pesë tematikave

| Tematika e OZhQ-ve | Qëllimet e OZhQ-ve (numri i qëllimeve) | Tërësisht në përputhje (numri i qëllimeve) | Përfshirja e tërësishme (%) | Pjesërisht në përputhje (numri i qëllimeve) | Përfshirja e pjesëshme (%) | Total % |
|----------------------------|--|--|-----------------------------|---|----------------------------|---------|
| Njerëzit ⁵ | 32 | 15 | 47% | 9 | 28% | 75% |
| Planetit ⁶ | 26 | 5 | 19% | 9 | 35% | 54% |
| Prosperiteti ⁷ | 32 | 10 | 31% | 15 | 47% | 78% |
| Paqja ⁸ | 10 | 3 | 30% | 5 | 50% | 80% |
| Partneritetet ⁹ | 11 | 3 | 27% | 4 | 36% | 63% |

Analiza tregon se Programi i Qeverisë ka një reflektim të ulët të qëllimeve të OZhQ-ve sipas tematikave, më të ulët se 50% të qëllimeve në secilën nga pesë fushat. Kjo sidomos vërehet më shumë në lidhje me qëllimet që bien në tematikën e Planetit, dhe Partneritetit ku reflektimi në Program të Qeverisë është vetëm 19% dhe 27% respektivisht. Tematika e Planetit mbulon fushat në lidhje me qëndrueshmërinë e mjedisit ku nuk reflektohen qëllimet që kanë të bëjnë me qasjen në shërbime sanitare dhe higjienë adekuate dhe të barabartë për të gjithë, me zbatimin e masave për konsum dhe prodhim të qëndrueshëm, të ulët humbja e ushqimit gjatë prodhimit dhe furnizimit, me inkurajimin e kompanive që të përdorin praktika të qëndrueshme, me promovimin e politikave të prokurimit publik që janë të qëndrueshme, që njerëzit të kenë informacionin e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mënyrën e jetesës, të trajtohet ndryshimi klimatik, ruajtja e ekosistemeve, biodiversitetin, dhe shfrytëzimi i burimeve gjenetike.

Ndërsa tematika e Partneritetit ka të bëjë me forcimin dhe rivitalizimin e partneritetit për zhvillim të qëndrueshëm duke filluar nga respektimi i politikave e deri të rritja e kapaciteteve për arritjen e OZhQ-ve. Informata të hollësishme rreth reflektimit të secilës nga qëllimet e OZhQ-ve në Programin e Qeverisë mund të gjeni informata të detajuara në aneks.

⁵ Nuk janë të përfshira 15 qëllimet e OZhQ-ve 1-5, pasi që nuk janë relevante për Kosovën.

⁶ Nuk janë të përfshira asnjë nga 10 qëllimet e OZhQ-14 dhe 10 qëllimet e OZhQ-6 dhe OZhQ-ve 12-15, pasi që nuk janë relevante për Kosovën.

⁷ Nuk janë të përfshira 13 qëllimet e OZhQ-ve 7-11, pasi që nuk janë relevante për Kosovën.

⁸ Nuk janë të përfshira 2 qëllimet e OZhQ-16, pasi që nuk janë relevante për Kosovën.

⁹ Nuk janë të përfshira 8 nga 19 qëllimet e OZhQ-17, pasi që nuk janë relevante për Kosovën.

IV. Përfundime dhe Rekomandime

Reflektimi dhe integrimi i Objektiveve për Zhvillim të Qëndrueshëm në dokumentet strategjike kombëtare është esenciale. Duke pasur parasysh fushë-veprimtarinë që mbulojnë OZhQ-të, zbatimi i tyre kontribuon edhe në zbatimin dhe përafrimin me politikat Evropiane. Kjo agjendë e vitit 2030 ka 17 objektiva, 169 qëllime (targets) dhe 232 tregues unik.

Objektivat si qëllime të përgjithshme, në një formë apo tjetër në programin e Qeverisë, por kjo nuk do të thotë që Kosova qëndron mirë në adresimin e OZhQ-ve pasi që në këtë program reflektohet një numër mjaft i vogël i qëllimeve të këtyre 16 objektiveve¹⁰. Vetëm 4 nga këto 16 objektiva reflektohen me mbi 50% në Programin e Qeverisë ndërsa 5 nga këto 16 objektiva kanë një reflektim nën 20% në Programin e Qeverisë. Në përgjithësi, programi nuk ka një gjithëpërfshirje të OZhQ-ve sipas kërkesave dhe standardeve të Kombeve të Bashkuara, në mënyrë që të jetë e mundur monitorimi dhe raportimi.

Analiza gjeti që përveç se në pjesë të konsiderueshme të OZhQ-ve nuk ishin integruar sa duhet në Planin Qeverisës, atyre u mungonte një analizë e thuktë e gjendjes aktuale, kostove të integritit të tyre dhe një kornizë e qartë e implementimit të tyre. Analiza sipas temave tregon se qëllimet e OZhQ-ve reflektohen në një nivel jo të kënaqshëm, sidomos në lidhje me qëllimet që bien në tematikën e Planetit, dhe Partneritetit ku reflektimi në Program të Qeverisë është vetëm 19% dhe 27% respektivisht.

Për këtë, është e rëndësishme që Qeveria të ndërtoj një kornizë të përgjithshme të matjes së progresit në zbatimin e OZhQ-ve dhe të ndikimit në OZhQ dhe atë:

¹⁰ Objektiva 14 nuk është përfshirë pasi që nuk është relevante për Kosovën.

- ◆ Një kornizë të matjes së përshtatshmërisë së nismave ligjore me zbatimin e OZhQ-ve
- ◆ Një kornizë të matjes së ndikimit rregullativ të Strategjive dhe dokumenteve tjera politike me kornizën e OZhQ-ve
- ◆ Një kornizë të matjes së ndikimit të projekteve kapitale të financuara nga çdo organizatë buxhetore shtetërore

Matja e përshtatshmërisë së nismave ligjore me zbatimin e OZhQ-ve do të mund të shërbente si një instrument për përcjelljen e mjedisit legjislativ të zbatimit të Objektivave dhe si një matës i progresit në fushën legjislative për secilën nga indikatorët që përmbajnë këto Objektivat. Në tabelat e përshtatshmërisë që përgatiten për secilën nismë ligjore, do të duhej të përfshihej edhe korniza e OZhQ-ve në atë mënyrë që të ketë një vlerësim analitik mbi bazën ligjore që ekziston, përmirësimet që janë bërë dhe si do të ndikojnë këto ndryshime ligjore në zbatimin më të mirë të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Secila strategji qoftë zhvillimore e Qeverisë qoftë sektoriale duhet të përmbajë kornizën e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Qeveria të sigurohet që strategjitë sektoriale harmonizojnë indikatorët e suksesit me indikatorët e OZhQ-ve. Në këtë mënyrë do të matet sukcesi i implementimit të objektivave por në të njëjtën kohë sektorët e caktuar kanë një pikënisje të matjes së suksesit. Integrimi i këtij instrumenti në dokumentet strategjike do t'u ndihmonte pastaj planeve të veprimit që duke shfrytëzuar indikatorët e OZhQ-ve të matej dhe monitorohej më lehtë zbatimi i politikave në sektorë të caktuar.

Investimet publike që bëhen nga organizatat buxhetore duhet të hyjnë nën kornizën e OZhQ-ve. Kjo kornizë u jep mundësi unike institucioneve të Kosovës që të përgatisin prioritetet e investimeve duke u bazuar në një bazë të matur e analitike të zbatimit të OZhQ-ve dhe nevojave për progres brenda këtyre fushave. Përveç fazës së planifikimit të investimeve, OZhQ-të ndihmojnë edhe në matjen e impaktit të investimeve kapitale në përmirësimin e jetës që

qytetarëve, zhvillimit ekonomik e social dhe përmirësimit të gjendjes së mjedisit. Planifikimi, hartimi dhe zbatimi i investimeve kapitale brenda kornizës së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, i mundëson Kosovës një zhvillim harmonik dhe të qëndrueshëm, shpërndarje të drejtë të investimeve bazuar në nevoja dhe mbledhje të të dhënave mbi progresin e arritur dhe sfidat për të ardhmen.

Integrimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në planin qeverisës nuk garanton zbatimin e tyre në praktikë nga ana e Qeverisë. Ato, duhen përcjellën nëpër agjencitë dhe organizat buxhetore shtetërore, në Strategjitë dhe dokumentet politike të Qeverisë dhe të përkthehen në agjendën legjislativë, të investimeve dhe të prioritetëve shtetërore. OZhQ-të ofrojnë një mundësi të mirë për Qeverinë e Kosovës që të ndërtohet një sistem i përcjelljes së progresit, i matjes së ndikimit qeverisës bazuar në ndikimin në zbatimin e Objektivave.

Reflektimi i qëllimeve të OZhQ-ve sipas objektivave të Programit të Qeverisë

| Objektivat / Sektori | OZhQ-1 Pa Varfëri | | | | | OZhQ-1 Zero Uri | | | | | OZhQ-3 Shendet i mirë dhe Mirëqenie | | | | | OZhQ-4 Arsimit dhe Cilesor | | | | | OZhQ-5 Barazimi dhe Gjinore | | | | | OZhQ-6 Ujë i pastërt dhe Kanalizime | | | | | | | | | | | | |
|---|-------------------|-----|-----|-----|-----|-----------------|-----|-----|-----|-----|-------------------------------------|-----|-----|-----|-----|----------------------------|-----|-----|-----|-----|-----------------------------|-----|-----|-----|-----|-------------------------------------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|
| | 1.1 | 1.2 | 1.3 | 1.4 | 1.5 | 2.1 | 2.2 | 2.3 | 2.4 | 2.5 | 3.1 | 3.2 | 3.3 | 3.4 | 3.5 | 3.6 | 3.7 | 3.8 | 3.9 | 4.1 | 4.2 | 4.3 | 4.4 | 4.5 | 4.6 | 4.7 | 5.1 | 5.2 | 5.3 | 5.4 | 5.5 | 5.6 | 6.1 | 6.2 | 6.3 | 6.4 | 6.5 | 6.6 |
| Menaxhimi i pandemisë nga Covid 19 | | | | | T | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Rimëkembja Ekonomike pas pandemisë | | | | | T | T | | | T | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Qeverisja, Reforma Institucionale dhe Kohezioni shoqëror | | | | | T | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | T | | | P | | | | | | | | |
| Zhvillimi Ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm | P | | | | T | T | | | | T | T | T | P | | | | | | | | | | | | | P | | | | | | | | | | | | |
| Drejtimi e pavarur dhe efikase | | | | | T | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | T | P | | | | | | | | | | | |
| Politika e Jashtme integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Arsimi dhe Shkenca | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | T | T | T | T | | | | | | | | | |
| Shëndetësia | | | | | T | | T | P | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Bujqësia dhe Zhvillimi Rural | | | | | | | T | | T | P | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Infrastruktura Energjia, Minierat, Ujërat dhe Ambienti | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Mbrojtja dhe Siguria Publike | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Mbrojtja Sociale dhe integrimi ne Punësim | | | | | T | T | T | T | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kultura, Rinia dhe Sporti | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Diaspora | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

Nuk është Relevante

Pjesërisht në Përputhje (P)

Tërësisht në Përputhje (T)

Nuk është në Përputhje

| Objektivat / Sektori | OZhQ-7 Energji e Përballueshme dhe e pastërt | | | OZhQ-8 Puna Dinjitoze dhe Rritje Ekonomike | | | | | | OZhQ-9 Industri Inovacion dhe Infrastrukturë | | | | | OZhQ-10 Zvogëlim i pabarazive | | | OZhQ-11 Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|--|-----|-----|--|-----|-----|-----|-----|-----|--|-----|-----|------|-----|-------------------------------|-----|-----|--|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|---|--|
| | 7.1 | 7.2 | 7.3 | 8.1 | 8.2 | 8.3 | 8.4 | 8.5 | 8.6 | 8.7 | 8.8 | 8.9 | 8.10 | 9.1 | 9.2 | 9.3 | 9.4 | 9.5 | 10.1 | 10.2 | 10.3 | 10.4 | 10.5 | 10.6 | 10.7 | 11.1 | 11.2 | 11.3 | 11.4 | 11.5 | 11.6 | 11.7 | | |
| Menaxhimi I pandemisë nga Covid 19 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | P | |
| Rimëkembja Ekonomike pas pandemisë | | | | | | | | | | | | | P | | | P | | | | T | | | | | | | | | | | | P | | |
| Qeverisja, Reforma Institucionale dhe Kohezioni shoqëror | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | T | | | | | | | | P | | | | | | |
| Zhvillimi Ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm | P | | | P | T | T | | P | P | | T | T | | | | P | P | P | | | | P | | | | | P | | P | P | | | | |
| Drejtimi e pavarur dhe efikase | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | P | | | | | | | | | | | | | |
| Politika e Jashtme integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Arsimi dhe Shkenca | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shëndetësia | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Bujqësia dhe Zhvillimi Rural | | | | | | | | | | | | | P | P | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Infrastruktura Energjia, Minierat, Ujërat dhe Ambienti | P | T | P | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Mbrojtja dhe Siguria Publike | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Mbrojtja Sociale dhe integrimi ne Punësim | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kultura, Rinia dhe Sporti | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Diaspora | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

Nuk është Relevante Pjesërisht në Përputhje (P)
 Tërësisht në Përputhje (T) Nuk është në Përputhje

| Objektivat / Sektori | OZhQ-12 Konsum dhe Prodhim I Përgjegjshëm | | | | | | OZhQ-13 Veprim për Klimën | | | OZhQ-14 Jeta nën Ujë | | | | | | OZhQ-15 Jeta në Tokë | | | | | | | | | |
|---|---|------|------|------|------|----------------|---------------------------|------|------|----------------------|------|------|------|------|------|----------------------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| | 12.1 | 12.2 | 12.3 | 12.4 | 12.5 | 12.6,12.7,12.8 | 13.1 | 13.2 | 13.3 | 14.1 | 14.2 | 14.3 | 14.4 | 14.5 | 14.6 | 14.7 | 15.1 | 15.2 | 15.3 | 15.4 | 15.5 | 15.6 | 15.7 | 15.8 | 15.9 |
| Menaxhimi I pandemisë nga Covid 19 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Rimëkembja Ekonomike pas pandemisë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Qeverisja, Reforma Institucionale dhe Kohezioni shoqëror | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Zhvillimi Ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qendrueshëm | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Drejhtësi e pavarur dhe efikase | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Politika e Jashtme integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Arsimi dhe Shkenca | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shëndetësia | | | | P | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Bujqësia dhe Zhvillimi Rural | | | | | | | | | | | | | | | | | P | T | P | | | | | P | |
| Infrastruktura Energjia, Minierat, Ujërat dhe Ambienti | | P | | T | P | | P | | P | | | | | | | | P | | | | | | | | |
| Mbrojtja dhe Siguria Publike | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Mbrojtja Sociale dhe integrimi ne Punësim | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kultura, Rinia dhe Sporti | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Diaspora | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

Nuk është Relevante Pjesërisht në Përputhje (P)
 Tërësisht në Përputhje (T) Nuk është në Përputhje

| Objektivat / Sektori | OZhQ-16 Paqe, Drejtësi dhe Institucione të forta | | | | | | | | | OZhQ-17 Partneritet për Objektivat | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|--|------|------|------|------|------|------|------|------|------------------------------------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|---|
| | 16.1 | 16.2 | 16.3 | 16.4 | 16.5 | 16.6 | 16.7 | 16.8 | 16.9 | 16.10 | 17.1 | 17.2 | 17.3 | 17.4 | 17.5 | 17.6 | 17.7 | 17.8 | 17.9 | 17.10 | 17.11 | 17.12 | 17.13 | 17.14 | 17.15 | 17.16 | 17.17 | 17.18 | 17.19 | |
| Menaxhimi I pandemisë nga Covid 19 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Rimëkembja Ekonomike pas pandemisë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Qeverisja, Reforma Institucionale dhe Kohezioni shoqëror | | P | P | P | P | P | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | T |
| Zhvillimi Ekonomik gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm | | | | | | | | | | T | | T | | | | | | P | | | P | | P | P | | | | | P | |
| Drejtësi e pavarur dhe efikase | | | T | P | P | P | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Politika e Jashtme integrimi në BE dhe dialogu me Serbinë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Arsimi dhe Shkenca | | | | | | | | | | | | | | | | | | P | | | | | | | | | | | | |
| Shëndetësia | | | | | | P | | | | | | | | | | T | | | | | | | | | | | | | | |
| Bujqësia dhe Zhvillimi Rural | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | P | | P | | | | | | |
| Infrastruktura Energjia, Minierat, Ujërat dhe Ambienti | | | | | | | | | | | | | | | | T | | | | | | | | | | | | | | T |
| Mbrojtja dhe Siguria Publike | | | | | | P | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Mbrojtja Sociale dhe integrimi ne Punësim | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kultura, Rinia dhe Sporti | | | | | | | | | | | | | | | | P | | | | | | | | | | | | | | |
| Diaspora | | | | | | | P | | T | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

Nuk është Relevante Pjesërisht në Përputhje (P)
 Tërësisht në Përputhje (T) Nuk është në Përputhje



ANALIZË: REFLEKTIMI I OBJEKTIVAVE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM NË PROGRAMIN E QEVERISË 2020 – 2023

Prishtinë // 2020

